BASHKIA KORÇE
NR 5775 PROT
DATA 13/06/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

# RELACION

Korçë, më 04.06.2025

## MBI
## MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NË BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT

Granti i Menjëhershëm(GM) është një instrument financiar i cili lehtëson blerjen e BKU(Banesave me Kosto të Ulët), për disa familje që i përkasin kategorive të përcaktuara në pikën 1, neni 46, të ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar.

Përfitojnë Grant të Menjëhershëm kategoritë e familjeve të cilat kanë në përbërje:

a)-një person me aftësi të kufizuara(PAK)në përputhje me përcaktimet e bëra në nënndarjen "i"të shkronjës c" të nenit 16 të këtij ligji

b)-një individ me statusin e jetimit që në momentin e aplikimit nuk ka mbushur 30 vjeç

c)-kryefamiljar i vetëm kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç

ç)- familje të minoriteteve rome dhe egjiptiane.

d)-familjet e punonjësve të policisë të rërë në detyrë

dh)-fëmijët në përkujdesje të Republikës

Granti i menjëhershëm akordohet nga buxheti i shtetit, nëpërmjet ministrisë që mbulon çështjet e strehimit MEKI, sipas procedurave, kritereve dhe përparësive të dhëna në VKM Nr.555 datë 15.07.2020 "Për proçedurat , kriteret dhe përparësitë për akordimin e Grantit të Menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit", në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët, përveç rasteve në kuptim të gërmave "d" e "dh" të pikës 1, neni 46 të ligjit, ku granti jepet në masën 20% të çmimit tyë shitjes së banesës me kosto të ulët.

Për të përfituar grantin e menjëhershëm GM, përfituesit e banesave me kosto të ulët të cilët për shkak të rënies në situatën e ndonjërit prej kushteve të parashikuara në ligj, kryejnë një aplikim në sistemin on-line të strehimit, nëpërmjet portalit qeveritar E-Albania, duke paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm si:

a) të dhënat e kontratës me subjektin, me të cilin individi/familja ka lidhur kontratën e kreditimit ose kontratën e shitblerjes së banesës me kosto të ulët.

b) faktin nëse individi/familja ka përfituar më parë nga programe për dhënie granti apo nga zbritje të vlerës së banesës, për shkak të statusit të familjes apo të ndonjë prej anëtarëve të saj.

Pas vlerësimit të aplikimeve të kryera në sistemin on-line të strehimit, nëpërmjet portalit unik qeveritar E-Albania, rezultojnë 4 familje në plotësim të kushteve për të përfituar nga G.M.(lista bashkangjitur).

Në zbatim të kushteve dhe afateve, kemi paraqitur pranë ministrisë përkatësë (MEKI), kërkesën për çelje fondi, shoqëruar me dokumentacionin e plote dhe kostot financiare sipas formatit të dhënë në shtojca (A) e VKM Nr.555 datë 15.07.2020 "Për proçedurat , kriteret dhe përparësitë për akordimin e Grantit të Menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit".Gjithashtu bazuar në pika 12 e VKM Nr.555 datë 15.07.2020 ku disponohet se *lista e përfituesve, e cila hartohet nga zyra përkatëse e njësisë së vetqeverisjes vendore, sipas dokumentacionit përkatës, vlerësohet nga struktura përgjegjëse për strehimin dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetqeverisjes vendore"mbas miratimit nga MEKI të fondit për grant të menjëhershëm për familjet dhe n*ë zbatim të:

-Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore",
-Ligjit nr. 22/2018 për "Strehimin Social" i ndryshuar, neni 46,
-VKM ne.555 datë 15.07.2020 "Për Proçedurat, Kriteret dhe Përparësitë për Akordimin e Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga Buxheti i Shtetit",
-Shkresës së MEKI me nr. prot 5013/2, datë 29.05.2025, protokolluar me tonën me nr.5264 datë 02.06.2025 mbi "Mbi fondet për grantin e menjëhershëm",
i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e listës së përfituesve sipas tabelës bashkangjitur me 4(katër) familje, të vlerësuara në përputhshmëri me kuadrin ligjor mbi akordimin e Grantit të Menjëhershëm për familjet me kontratë në banesat me kosto të ulët.

Drejtore/Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
**Mirela Balli**

Drejtore/Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
**Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

Drejtore e Financës, Buxhetit dhe MFK
**Valbona Ziko**

KRYETARE E KOMISIONIT TË STREHIMIT
**Benila THEMELI**

KRYETARI I BASHKISË
**Sotiraq FILO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

Tabela 1. Familjet përfituese të Grantit të Menjëhershëm sipas kategorive , pika 1 neni 46, e ligjit 22/2018 i ndryshuar.

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Kategoria e përfituesit sipas pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 22/2018 | Kontrata e lidhur me (p.sh. EKB ose Banka) |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Robert Zejnel Bajram | (ç) | EKB |
| 2 | Liri Hysen Dido | (a) | EKB |
| 3 | Endri Pëllumb Bostanxhi | (ç) | EKB |
| 4 | Rajmond Riza Hamzallari | (a) | EKB |

(a)- një person me aftësi të kufizuar (PAK) në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 16 të ligjit 22/2018"Për Strehimin Social"
(ç)- individ/familje të minoriteteve Rome dhe Egjyptian

**Drejtore**
Mirela Balli

Kryetare e Komisionit të Strehimit
**Benila THEMELI**

KRYETARI I BASHKISË
**Sotiraq FILO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

Nr.____________. datë____________.2025

**MBI**
**MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NË BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT.**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, neni 46, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.555 datë 15.07.2020 "Për Proçedurat, Kriteret dhe Përparësitë për Akordimin e Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga Buxheti i Shtetit", bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me vlerësimin e Komisionit të Strehimit, Këshilli Bashkiak Korçë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përfitues të Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga Buxheti i Shtetit 4(katër) familjet aplikante sipas listës bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me ________vota

Vota Pro______

Vota Kundër_______

Vota Abstenim__________

Zbardhur më datë_________

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Ana VERUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

Tabela 1. Familjet përfituese të Grantit të Menjëhershëm sipas kategorive , pika 1 neni 46, e ligjit 22/2018 i ndryshuar.

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Kategoria e përfituesit sipas pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 22/2018 | Kontrata e lidhur me (p.sh. EKB ose Banka) |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Robert Zejnel Bajram | (ç) | EKB |
| 2 | Liri Hysen Dido | (a) | EKB |
| 3 | Endri Pëllumb Bostanxhi | (ç) | EKB |
| 4 | Rajmond Riza Hamzallari | (a) | EKB |

(a)- një person me aftësi të kufizuar (PAK) në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 16 të ligjit 22/2018"Për Strehimin Social"
(ç)- individ/familje të minoriteteve Rome dhe Egjyptian

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Ana VERUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr.____________. datë____________.2025

**MBI**

**MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NË BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, neni 46, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.555 datë 15.07.2020 "Për Proçedurat, Kriteret dhe Përparësitë për Akordimin e Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga Buxheti i Shtetit", bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me vlerësimin e Komisionit të Strehimit, Këshilli Bashkiak Korçë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përfitues të Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga Buxheti i Shtetit 4 (katër) familjet aplikante sipas listës bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me ________vota

Vota Pro______

Vota Kundër_______

Vota Abstenim__________

Zbardhur më datë__________

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Ana VERUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

Tabela 1. Familjet përfituese të Grantit të Menjëhershëm sipas kategorive , pika 1 neni 46, e ligjit 22/2018 i ndryshuar.

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Kategoria e përfituesit sipas pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 22/2018 | Kontrata e lidhur me (p.sh. EKB ose Banka) |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Robert Zejnel Bajram | (ç) | EKB |
| 2 | Liri Hysen Dido | (a) | EKB |
| 3 | Endri Pëllumb Bostanxhi | (ç) | EKB |
| 4 | Rajmond Riza Hamzallari | (a) | EKB |

(a)- një person me aftësi të kufizuar (PAK) në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 16 të ligjit 22/2018"Për Strehimin Social"
(ç)- individ/familje të minoriteteve Rome dhe Egjyptian

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Ana VERUSHI**